



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 8205 Prot.

Tiranë, më 16.10. 2015

URDHËR
Nr. 392 datë 16.10.2015

**PËR
SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË TRANSFERIMIT TË STUDIMEVE, NË
PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË VITIN AKADEMIK 2015-2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 18, 70, 71, 77 dhe 89 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 808, datë 3.10.2015, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016",

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të transferimit të studimeve, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, në vitin akademik 2015-2016, sipas tabelës bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA


MINISTËR



TABELA

KUOTAT E TRANSERIMEVE NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Ministria e Shëndetësisë
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	4	Dermatologji	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	8	Diagnozë me imazhe	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	22	Obstetrikë gjinekologji	1
		TOTALI	3